

VENDIM
Nr. 537, datë 19.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1; 14, pika 1; 18, pika 1; 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës “B”, të titulluar “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, çregjistrohet kompania e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së
(LISTA E OKB-së)

B) LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME TALIBANËT

a) Lista e ndryshuar në **“Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”**:

1. DIRECTORATE GENERAL OF GEOLOGICAL SURVEY AND MINERAL INVESTIGATION.

C) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”**:

1. ADNAN; ABOU WALID; AL-SAHRAOUI.
2. MOHAMMED, YUSIP, KARIM.
3. MOHAMAD, RAFI, BIN UDIN.
4. MUHAMMED, REZA, LAHAMAN, KIRAM.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.